



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA/OFFICE OF  
THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i dokumentit 21.6.1-2008-08**

**RAPORT FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË  
MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2008**

**Prishtinë, 24 Qershor 2009**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Qasja e auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
  - 1. Pasqyrat financiare
  - 2. Sistemi i kontrollit dhe
  - 3. Auditimi i brendeshem
  - 4. Te hyrat
  - 5. Pagat dhe mëditjet
  - 6. Shpenzimet përmes procedurave prokurimit
  - 7. Menaxhimi i Pasurisë
  - 8. Menaxhimi i automjeteve

### **Anekset**

**I.** Llojet e ndryshme të opinioneve të auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në raportet vjetore të auditimit për vitin 2009.

**II.** Komentet e MMPH dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj komenteve.

## **Lista e shkurtesave**

AKMM	Agjencioni Kosovar për Mbrojtje të Mjedisit
AP	Auditori Përgjithshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IHM	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzim Administrativ
VNM-	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZAP	Zyra e Auditorit Përgjithshëm

## **I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, Pasqyrat Financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtet, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit hapësinor më 31 dhjetor 2008 si dhe rezultatet e aktiviteteve të saj për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Auditimi i pasqyrave financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi në të gjitha fushat kryesore, të cilat duhet të adresohen urgjentisht nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i organizatës.

Auditimi ynë ka identifikuar këto të gjetura kryesore të auditimit:

- Mungese e një sistemi adekuat të evidentimit të të Hyrave për nga lloji dhe kategoria si dhe mungese e kontrollit për aprovimet e pëlqimeve mjedisore.
- Anashkalim i procedurave ligjore të rekrutimit të personelit .
- Dobësi në menaxhimin e shpenzimeve të cilat janë realizuar përmes procedurave të prokurimit.
- Mungesë e kontrollit adekuat sa i përket menaxhimit të pasurisë si dhe menaxhimit të automjeteve .
- Mos funksionimi i Njesisë së auditimit të brendshëm në periudhën kohore janar –qershor 2008.

Gjate auditimit, ZAP ka vërejtur se nuk ekziston një sistem adekuat i funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Në tërësi auditimi ka rezultuar me gjithsej 19 rekomandime kryesore, të cilat duhet të adresohen menjëherë nga menaxhmenti sa u përket:

## **II. HYRJE**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor (MMPH) të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

## **III. GJENDJA E REKOMANDIMEVE TË VITEVE TË KALUARA**

Auditimi i ZAP mbi pasqyrat financiare të MMPH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007 kishte rezultuar me 5 rekomandime të auditimit. Auditimi ynë i tanishëm ka përcaktuar që MMPH-ja nuk i ka implementuar rekomandimet e dhëna nga ZAP. Ato me të rëndësishmet janë:

- (a) Siguroj që të gjitha shënimet e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare janë mbajtur dhe përgatitur në pajtim të plotë me kërkesat përkatëse ligjore.
- (b) MMPH duhet të mbaj një regjistër të azhurnuar për të hyrat e mbledhura sipas LMFPP
- (c) Duhet të ndërmarrën hapa të menjëhershëm që në meny të ndjeshme të përmirësohen kontrollet e brendshme në lidhje me prokurimet në MMPH.

Është e rëndësishme të përmendet që për mendimin tonë mos implementimi i rekomandimeve është arsye për shqetësim. Moszbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar jep të kuptohet se dobësitë e mëhershme mund të ekzistojnë ende.

## **IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**

Ky auditim i MMPH ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008. Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të MMPH, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative

## V. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 19.02.2009 deri më 13.03.2009 në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MMPH në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MMPH janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MMPH, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MMPH-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinionin i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

## VI. OPINION I AUDITIMIT

Për mendimin tonë pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të MMPH-së deri më 31 dhjetor 2008 dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik sipas “ Raportimit financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme” që paraqiten në Aneksin 1.

Auditimi ka identifikuar mangësi serioze në kontrollet e brendshme të MMPH-së. Testimi substancial ka shpalosur keqdeklarime dhe gabime materiale që kanë pasur efekte në Pasqyrat Financiare të MMPH-së të paraqitura në këto pasqyra.

Pasqyrat Financiare duhet të përgatiten në përputhje me UA të MEF nr 2008/13 “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”, mirëpo nga auditimi ynë i pasqyrave financiare kemi vërejtur se entiteti nuk i është përmbajtur këtij udhëzimi. Pasuritë nuk janë të prezantuara në pasqyra financiare, pastaj janë vërejtur diferenca në mes të hyrave të prezantuara në P/F dhe raporteve të brendshme të hyrave. Po ashtu janë evidentuar dobësi në menaxhimin e shpenzimeve që kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit si dhe menaxhim i dobët i pasurisë.

## **VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KRYESORE TË AUDITIMIT**

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e prezantimit dhe shpalosjeve të pasqyrave financiare dhe në kryerjen e testeve substanciale për të konfirmuar saktësinë dhe validitetin e transaksioneve financiare. Krahas këtyre, kemi ekzaminuar punën e auditimit të brendshëm, nga i cili pritet të rishikojë dhe të raportojë për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të sistemeve dhe proceseve kryesore.

Menaxhmenti duhet të siguroj ekzistimin e aktiviteteve të kontrollit dhe që ato të kryhen rreth proceseve që janë nën kontrollin e tyre. Menaxhmenti është përgjegjës për aplikimin e kontrolleve të mjaftueshme për të siguruar që rreziqet të minimizohen në nivel të pranueshëm.

Të gjeturat kryesore janë grupuar sipas klasifikimit të shpenzimeve , të hyrave e po ashtu janë dhënë shembuj për të konfirmuar konkluzionet dhe rekomandimet tona. Kemi theksuar shembuj të ndryshëm të kontrollit të brendshëm të dobët në secilën pjesë të të gjeturave duke dhënë po ashtu rekomandime për përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim paraqesim të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit që kanë rezultuar nga auditimi ynë i pasqyrave financiare dhe procesi i testimit substancial.

### **1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar**

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Me Rregulloren nr. 2008/13 MMPH-se i është ndare Buxhet në vlerë 12,289,461 euro ,kurse me rishikimin e buxhetit në baze të Ligjit 03/L-093 buxheti ka qene 12,405,889 ,ndërsa shpenzimet gjatë vitit 2008 kanë qene 4,719,027 euro. Nga të dhënat e prezantuara shihet se MMPH ka shpenzuar vetëm 38% të buxhetit të saj .Obligimet e bartura për tu paguara për vitin 2009 janë në vlerë 269.552 euro.

Të hyrat e mbledhura nga burimet vetanake për vitin 2008 ishin 79,939 euro ,ndërsa për vitin 2008 ,MMPH nuk kishte një planifikim të hyrave vetanake .

#### **Konkluzioni**

Bazuar në buxhetin e aprovuar si dhe realizimin e shpenzimeve mund të nxjerrim një konkludim se MMPH nuk i vë në funksion të gjithë mekanizmat e saj me qëllim të realizimit të shpenzimeve të planifikuara.

#### **Rekomandim 1**

Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që të merr të gjitha masat e duhura në mënyrë që realizimi i shpenzimeve të bëhet në pajtim me planifikimet buxhetore .

## **2. PASQYRAT FINANCIARE**

Pasqyrat Financiare (PF) duhet të përgatiten nga secili entitet i pavarur, bazuar në regjistrat e vet kontabël dhe asisoj që të paraqesin përgjegjshmëri dhe transparencë në shfrytëzimin e parasë publike. Format i tyre kërkon shpalosje dhe shpjegime shtesë në formë të Shënimeve, që siguron informacion për lexuesit.

Ligji Nr. 03/L-048 “Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë” përcakton rregullat e përgatitjes dhe barazimit të pasqyrave financiare për të gjitha organizatat buxhetore.

Për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-048 (neni 44 ) kërkohet që:

- Zyrtari kryesor Financiar i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me Rregullat për Kontrollin dhe Menaxhimin Financiar (KMF) dhe të sigurojë kopjet e regjistrave kontabël për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- Drejtori Ekzekutiv Financiar i një organizate buxhetore brenda 30 ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal duhet të siguroi drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit (i) pasqyrat e pa-audituar financiare të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal (ii) një konfirmim që pasqyrat financiare janë një pasqyrim real dhe i saktë i financave dhe transaksioneve financiare të vitit në fjalë.
- Drejtori i Thesarit, brenda nëntëdhjetë ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal, do të (i) barazojë llogaritë financiare që i merr, me llogaritë fiskale dhe gjendjet e parave të gatshme si dhe (ii) për qëllime auditimi do t’i japë Auditorit Gjeneral llogaritë financiare për të gjitha organizatat buxhetore

Pasqyrat Financiare është dashur të përgatiten në përputhje me UA të MEF nr 2008/13 “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”, mirëpo nga auditimi ynë i pasqyrave financiare kemi vërejtur se entiteti nuk i është përmbajtur këtij Udhëzimi në baze të cilit kërkohet që pasurit të prezantohen në pasqyra financiare, po ashtu ekzistojnë diferenca në mes të hyrave të prezantuar në P/F dhe raporteve të brendshme të të hyrave .

## **3. REALIZIMI BUXHETIT**

### **3.1 TE HYRAT**

Gjate vitit 2008 MMPH ka realizuar të hyra në shumë prej 79,939 sipas sistemit të SIMFK dhe pasqyrave financiare ,ndërsa sipas raporteve të brendshme të entitetit të hyrat e realizuar ishin 72,762 euro

Vendimi Nr. 77 të datës 15.12.2006 i nxjerre nga Ministri, përcakton këto lloje të taksave:

- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Lejes Ekologjike Mjedisore
- Shqyrtimin dhe lëshimin e Lejes Ujore
- Lëshim i objekteve me qira

### 3.1.1 Të gjeturat

Ekziston një diferencë në mes të hyrave të prezantuara në P/F të organizatës buxhetore dhe raporteve të brendshme rreth të hyrave të entitetit .Në pasqyra financiare është paraqitur shuma e njëjtë që është raportuar edhe në raportet e Thesarit, dhe pasqyrat nuk janë bërë në bazë të regjistrave kontabël të Ministrisë.

Tab 1: Të hyrat

SIMFK	P/F te Organizatës Buxhetore	Raporteve e brendshme
79,939	79.939	72,762
<b>79,939</b>	<b>79.939</b>	<b>72,762</b>

- Nga tabela 1 shihet se nuk ekziston një sistem adekuat i regjistrimit të hyrave ,ku evidentohet qartë lloji i të hyrave dhe kategoria e të hyrave .

### Konkluzioni

Diferenca e prezantuar e të hyrave në mes P/F dhe raporteve të brendshme të entitetit , mungesa e evidencave sipas llojit dhe kategorisë se të hyrave ndikon qe P/ F të paraqesin një gjendje jo të drejt dhe të qarte të të hyrave.

### Rekomandimi 2

#### Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH –se qe siguroj:

- Harmonizim për çdo muaj të gjitha kategoritë e të hyrave me Sistemin “Free Balance” të Thesarit.
- Duhet të mbajë një regjistër të azhurnuar për të hyrat e mbledhura sipas llojit dhe kategorisë se të hyrave , respektivisht të veprave në pajtim me UA. nr. 6/2007 Standardi i Unifikuar për Numra Referent për Grumbullimin e të Hyrave Publike.
- Pasqyrat financiare të përpilohen në bazë të dhënave në regjistrat kontabël të MMPH-së dhe jo të përshkruhen evidencat e marra nga Thesari.

### 3.1.2. E Gjetura

- Gjate ekzaminimit të lendeve për pëlqime mjedisore, MMPH nuk e ka kërkuar mendimin e AKMM për VMN , siç është përcaktuar në nenin 21.3 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe UA 9/2004 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- Me rastin e ekzaminimit të dhjetë(10) lendeve nga 160 për pëlqime mjedisore qe ka dhënë MMPH gjatë 2008, kemi vërejtur se MMPH ,ka aprovuar pëlqime mjedisore pa u respektuar dispozitat e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij. Në katër(4) raste ka aprovuar pëlqime mjedisore duke i anashkaluar rekomandimet të komisionit për VNM.(rekomandime të komisionit për refuzime dhe kërkesat e komisionit për informata shtese).

## **Konkluzion**

Anashkalimi i mendimit të AKMM-se për vlerësimin e ndikimit në ambient, si dhe aprovimi i pëlqimeve mjedisore pa u respektuar procedurat ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara nga legjislativi në lidhje me Mbrojtjen e Mjedisit.

## **Rekomandimi 3**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që me rastin e aprovimeve për pëlqime mjedisore të respektoj me përpikëri dispozitat e Ligjit Nr 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 26.02.2009

### **3.1.3. E Gjetura**

Gjate ekzaminimit të lëndës lëshimi i objektit me qira në hapësirat e IHM, MMPH ka lidhur kontratë me qiramarrësin duke anashkaluar procedurat e hapura për oferta publike, si dhe kontrata është lidhur me datën 09/01/07 me nr 06/32/2 nga zyrtari me i lartë administrativ i MMPH.

## **Konkluzion**

Lëshimi i objekteve qeveritare me qira duke i anashkaluar procedurat e hapura për oferta publike, ndikon në diskriminim, jo transparencë si dhe në eliminimin e konkurrencës së ndershme.

## **Rekomandimi 4**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që me rastin e lëshimit të objekteve me qira të veprojnë në pajtim me nenin 24 të LPP për nënshkrimin e kontratave publike, të bejnë përzgjedhjen e bazuar në procedurat jo diskriminuese, të hapura, transparente dhe të drejta në përputhje me LPP.

## **3.2 PAGAT DHE MËDITJET**

Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve për vitin 2008 janë 679,525 euro. ZAP ka testuar këto të dhëna duke i vënë në raport me të dhënat sipas sistemit të pagave në MMPH dhe me librin kryesor të thesarit. Mesatarja e punëtorëve në MMPH gjatë vitit 2008 ka qenë 212. Sa i përket dosjeve të personelit në kemi përzgjedhë 21 mostra për testim.

### **3.2.1. Te gjeturat**

Gjate ekzaminimit të lendeve në disa raste kemi hasur se:

- Mungojnë kërkesat për nismën e rekrutimit
- Mungojnë vendimet për formimin e komisionit për selektimin e kandidatëve
- Nuk e respektohen kriteret e konkursit gjatë vlerësimit të kandidatëve

## **Konkluzion**

Mungesa e kërkesës për rekrutim të stafit, vendimeve të formimit të komisionit dhe mosrespektimi

i kritereve te konkursit përbejnë shkelje te Rregullatives Ligjore për Shërbimin Civil dhe si pasoje mund te shkaktoj eliminimin e përzgjedhjes se kandidatëve te kualifikuar .

### **Rekomandimi 5**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që te inicioj kërkesat për nismën e rekrutimit ,te formoje komisionet për selektimin e kandidatëve , te respektoj kriteret e konkursit qe janë përcaktuar, si dhe te veproj ne përpikëri me procedurat e rekrutimit te parapara me Udhëzimin Administrativ nr. MSHP/ DASHC 2003/01.

### **3.3 SHPENZIMET PERMES PROCEDURAVE TE PROKURIMIT**

Ligji nr. 2003/17 Për Prokurim Publik i Amandamentuar përcakton kërkesat të cilat duhet të respektohen për shfrytëzimin e mjeteve publike në aktivitetin e prokurimit. Parimet e përgjithshme të LPP-së nënkuptojnë ekonomizimin, efektivitetin, barabarësinë dhe drejtësinë për të gjitha kontratat e prokurimit.

Gjate vitit 2008 MMPH-ja ka bere shpenzime në vlere 4,039,502 euro ,ndërsa shpenzimet qe janë realizuar përmes procedurave të prokurimit gjithsej arrijnë shumen prej 2,505,095 euro.

Ne baze te gjykimit tone ne kemi përzgjedh për testim 9 lende me vlere te mesme dhe të mëdha në vlere 1,747,410 euro si dhe 6 lende me kuotim çmimesh ne vlere 40,293 euro

#### **3.3.1. Prokurimi i realizuar jashtë planit të prokurimit**

Gjate ekzaminimit te disa lendeve kemi vërejtur se këto lende nuk kane qene te përfshira ne planin e prokurimit

- Kontratë për furnizim me Reagensë me nr. prokurimit 210/08/014/136 në vlerë prej 9,880 euro.
- Rregullimi i parkut në Mitrovice me nr. te prokurimit 210/08/061/521 në vlere 52,893 euro.

### **Konkluzion**

Planifikimi jo adekuat i aktiviteteve të prokurimit mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave përkatës dhe qëllimin e ndarjeve buxhetore te entitetit.

### **Rekomandimi 6**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që ti përmbahet planit te aprovuar te prokurimit dhe qe blerjet e mallrave dhe shërbimeve të jene të parapara me kohe, ashtu siq e parasheh neni 7 i LPP-se nr-2003/17

#### **3.3.2. Nënshkrimi (Lidhja ) i kontratave para vlerësimit te ofertave**

Me rastin e ekzaminimit të lendeve kemi vërejtur se ,MMPH ka lidhur kontrata para vlerësimit të ofertave te ofertuesve, siç janë

- Furnizim me Reagensë me nr prokurim 210/08/014/136 ne vlerë prej 9,880 euro,MMPH ka nënshkruar kontratën me datën 24.04.2008 , ndërsa raporti i vlerësimit nga komisioni i vlerësimit më datën 30.04.2008.
- Furnizimi me Flamuj me nr prokurimi 210/08/009/136 ne vlere 4,691 euro MMPH ka nënshkruar kontratën 04.04.2008 ,ndërsa raporti i komisionit te vlerësimit me 25.04.2008

### **3.3.3. Nënshkrimi (Lidhja ) i kontratave para zotimit te Mjeteve**

Me rastin e ekzaminimit të këtyre lendeve ,MMPH ka hyre ne obligime kontraktuese para zotimit te mjeteve.

- Furnizim me Reagensë më nr prokurim 210/08/014/136 ne vlerë prej 9,880 euro,MMPH ka nënshkruar kontratën me datën 24.04.2009 , ndërsa zotimi i mjete është bere me datën 20.05.2009
- Furnizim me Flamuj me nr prokurimi 210/08/009/136 ne vlere 4,691 euro MMPH ka nënshkruar kontratën 04.04.2008 , ndërsa zotimi i mjeteve prej 2,700 euro është bere me 04.04.2008 dhe vlere 2,023 euro më 02.08.2008.
- Furnizim me telefona mobil me nr prokurimi 210/08/006/136 në vlerë 6930 zotimi i mjeteve është bere në vlerë 4500 , ndërsa kontrata 6930 euro ,pjesa tjetër e zotimit është bere me datën 21.11.2008 në vlere 3000 euro.

### **Konkluzion**

Hyrja e entitetit në obligime pa zotimin e mjeteve përmban në vete një rrezik se obligimet nuk mund të kryhen në të ardhmen, mund të krijohen shpenzime te cilat nuk mund te mbuloohen..

### **Rekomandimi 7**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH qe ti zotojn mjetet para se te fillohet më ushtrimin e aktiviteteve te prokurimit dhe ti përmbahet Nenit 8.2 te Ligjit te Prokurimit dhe ti aplikojë Udhëzimet e Thesarit. .

### **3.3.4. Kryerja e pagesave pa raporte teknike të pranimit të punëve**

Gjate ekzaminimit te këtyre lendeve kemi vërejtur se operatorëve ekonomik i është kryer pagesa ne mungesë te raporteve teknike te cilat paraqesin sakte se cilat pozicione apo punë janë realizuar gjate punimeve .

- Rregullimi i parkut në Mitrovice me nr. prokurimit 210/08/061/521 ne vlere 52,893 euro. Kemi vërejtur se entiteti ka kryer pagesë 7,893 euro parapagim (kësti I) pas lidhjes se kontratës si dhe ka paguar këstin e dyte në vlere 13,174 euro ndaj operatorit ekonomik pa raporte të pranimit për punët e kryera.
- Rehabilitimi i deponisë se mbeturinave ne Ferizaj me nr. kontratës 210/08/028/521 ne vlere 148,945 euro .
- Ekzekutimi i punëve ne kompleksin memorial Adem Jashari në Prekaz, faza IV e punimeve me nr. prokurimi 210/08/025/511 ne vlere prej 982,000 euro, ndërsa vlere e paguar në tre këste ishte 589,200 euro.
- Rregullimi i shtratit te lumit ,”Shushica” ne Istog me nr. prokurimi 210/08/007/521 ne vlerë 249,130, si dhe aneks kontrata me datën 27/10/2008 ne vlere 24,860 euro .Vlere e paguar për këtë kontrate ka qene ne vlere 271,660 euro. Koordinatorja e përcjelljes se kryerjes se projektit nga MMPH, ka pasur vërejtje ne organin mbikëqyrës se mbikëqyrje nuk ka qene ne mënyre profesionale, nuk kane ofruar ditar pune, libër pune, si dhe vërejtje rreth realizimit te punimeve nga operatori ekonomik, mirëpo MMPH nuk ka marre masa ndaj këtyre vërejtjeve .

## **Konkluzion**

Kryerja e pagesave pa raporte teknike te pranimit te punëve te cilat paraqesin sakte pozicionet e realizuara te punimeve ,mallrave si dhe shërbimeve ,rrit rrezikun për keq përdorim te fondeve te ndara për investime publike.

## **Rekomandimi 8**

- Rekomandojmë Menxhmentin e MMPH të ketë dëshmi të dokumentuara qe janë pranuar punët,mallrat ,shërbimet para se te behet pagesa e fondeve publike për një furnizues,respektivisht duhet të vepohet në pajtim me piken 7.1 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit - 02 Shpenzimi i parasë publike.

### **3.3.5. Mos respektim i afatit te kontraktuar për ekzekutimin e punimeve**

Me rastin e ekzaminimit të këtyre lendeve ,kemi vërejtur se operatoret ekonomik nuk e kane respektuar planin dinamik për kryerjen e punimeve edhe pse plani dinamik ka qene kriter për vlerësimin e ofertave dhe ka tërhequr 20% të poenaëve me rastin e vlerësimit te ofertave .

- Gjate ekzaminimit te lendes Rehabilitimi i deponimit se mbeturinave ne Ferizaj me nr prokurimi- 210/08/028/521 me datën 10/09/2008 ne vlere 148,945 euro .Realizimi punimeve nuk është bere sipas planit dinamik. Sipas kontratës është parapare qe punimet te përfundojnë për 21 dite ,ndërsa raporti përfundimtar mbi kryerjen e punimeve është me datën 27/11/2008.
- Gjate ekzaminimit te lendes Rehabilitimi i deponis se mbeturinave ne Gjilan me nr prokurimit 210/08/030/521, me datën18/09/2008 në vlerë 76,940 euro ,kemi vërejtur se realizimi i punimeve nuk është bere sipas planit dinamik ku ne kontrate është parapare që punimet te përfundojnë 18 dite pas nënshkrimit te kontratës ,ndërsa pas dy muajve te nënshkrimit te kontratës është kryer 50% e punimeve .

## **Konkluzion**

Mos aplikimi i masave te marra te përcaktuar ne kontrate nëse entiteti nuk i kryen obligimet ne baze te kontratës do te ndikoje ne mos arrijten e objektivave te përcaktuar nga entiteti

## **Rekomandimi 9**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH qe te veproje konform planit dinamik te përcaktuar në kontratë me Operatorin ekonomik nëse subjekti nuk i përmbahet kontratës për realizimin shërbimeve apo punimeve te parapara ne kontrate duhet ti ndërmarr masat ndëshkuese te parapara ne kontrate.

### **3.3.6. Mungesa e komisioneve për pranimin punëve**

Gjate ekzaminimit te këtyre lendeve kemi vërejtur se MMPH nuk ka formuar komisione për pranimin të punëve të realizuar nga operatoret ekonomik për.

- Rehabilitimi i deponis se mbeturinave ne Ferizaj me nr prokurimi 210/08/028/521 në vlere 148,945 € .
- Ekzekutimi i punëve ne kompleksi memorial Adem Jashari -Prekaz faza IV e punimeve me nr prokurimi 210/08/025/511 ne vlere prej 981.999,91, ndërsa vlera e paguar ne tre

këste 589,200 euro. .

- Rregullimi i parkut në Mitrovice me nr prokurimi 210/08/061/521 ne vlere 52,893 euro ,entiteti ka kryer pagës 7,893 parapagim (kësti I) pas lidhjes se kontratës si dhe ka paguar këstin e dyte në vlere 13,174 .

### **Konkluzion**

Kjo krijon mundësin qe të pranohen punët të cilat nuk i përmbushin kërkesat e kontraktuara dhe kriteret për shkak të mungesës së komisioneve mbi pranimin e punëve

### **Rekomandim 10**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH qe me rastin e pranimin te punëve të realizuar nga operoret ekonomik MMPH të formoj komision për pranimin e punëve në mënyre qe punët e realizuar te jene ne përputhje me specifikat e kërkuara .

### **3.3.7. Furnizime me derivate të naftës dhe benzinë për nevoja të MMPH**

Gjate ekzaminimit te lendes Furnizime me derivate të naftës dhe benzinë për nevoja të MMPH me nr prokurimi 210/07/009/111, vlere e shpenzimeve për derivate te automjeteve 126,161,00 kurse ne kemi testuar lende në vlere 34,795 euro.

MMPH ka lidhur kontrate me operatorin ekonomik sipas Çmimin /L, fikse apo ne baze te Burses. Me rastin e ekzaminimit të pagesave për shpenzimet e derivateve ,operatori ekonomik i cili ka bere furnizimin me derivate ne fatura ka përfshire përveç çmimeve te përcaktuara sipas Burses edhe një vlere shtesë (Premium ) e cila shtesë nuk është parapare ne kontrate.

### **Konkluzion**

Përfshirja e një vlere shtesë (Premium) ,ne faturë si dhe pagesës e kësaj shtese ndikon ne mos respektimi i kriterëve te përcaktuara ne kontrate dhe dëmtimi e buxhetit te ministrisë.

### **Rekomandim 11**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH qe me rastin e furnizimit me derivate t'u përmbahet në mënyrë rigoroze dispozitave te përcaktuara ne kontrate.,
- Menaxhmenti i MMPH-së duhet ta rishikoj thellësisht këtë rast dhe të merren masat adekuate..

### **3.3.8. Furnizim me pije dhe mjete pune për nevojat e MMPH**

Gjate ekzaminimit te lendes furnizim me pije dhe mjete pune për nevojat e MMPH ,ne baze te nr prokurimi 210/07/022/235 në vlere 9,794 euro, ne specifikacionin teknik te dosjes se tenderit janë përfshire pije dhe mjete pune ,ku ne baze te këtyre specifikave është zgjedhur edhe operatori ekonomik për furnizim. Mirëpo gjate ekzaminimit te lendes shihet se entiteti fare nuk është furnizuar me mjete pune.

### **Konkluzion**

Përfshirja e zërave (artikujve ) në specifikacionin teknik te dosjes se tenderit të cilat entitetit nuk i nevojiten të furnizohet ,ndikon që gjate vlerësimit te ofertave te zgjedhën ofertat e pa

përgjegjshme, respektivisht përfshirja e artikujve të panevojshëm në dosjen e tenderit ndikon në ndryshimin e çmimit total të ofertës. Po ashtu aplikimi i metodave të tilla rrit mundësinë e mashtrimeve dhe eliminon konkurrencën e ndershme

### **Rekomandim 12**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që me rastin e specifikimit teknik të dosjes së tenderit të mos futen artikujt të cilët entiteti nuk ka nevojë furnizimi për këta artikuj.

### **3.3.9. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit**

Gjate ekzaminimit të lendeve udhëtimet zyrtare jashtë vendit kemi vërejtur se kanë munguar dokumentet që e arsyetojnë qëllimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri me datën 27 deri më 30 Nëntor 2008, për ndere të festës 28 Nëntorit.

### **Konkluzion**

Mungesa e ftesave zyrtare dhe dokumenteve tjera që kërkohen me UA. nr.2004/07 Për Udhëtimet Zyrtare ndikon në instalimin e praktikave joligjore në Ministri dhe në shpenzime të buxhetit për qëllime të pa përcaktuara ligjore.

### **Rekomandim 13**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që me rastin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të përmbahet UA 2004/07 për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

### **3.3.10. Shpenzimet e telefonisë mobile dhe fikse**

Gjate ekzaminimit të lendes shpenzimet e telefonisë mobile dhe fikse kemi vërejtur:

- Tejkallim të shpenzimeve të telefonisë fikse dhe roaming.
- Lejimi për shfrytëzim i telefonave roaming edhe për zyrtarët të cilët nuk kanë të drejtë shfrytëzimi të telefonave roaming sipas UA-04/2008.
- Sa i përket shpenzimeve të kartelave mbushëse, shihet se mungon një evidencë e qarte e zyrtarëve që marrin kartela mbushëse.
- Shfrytëzimi i telefonave roaming të MMPH edhe për zyrtarët e suspenduar.

### **Konkluzion**

Shfrytëzim joracional i telefonave mobil dhe fikse, duke anashkaluar UA.nr. 04/2008 ndikon në shkeljen e politikave të përcaktuara qeveritare si dhe shfrytëzimi jo racional të buxhetit të ministrisë.

### **Rekomandim 14**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile të jenë në përpikëri me dispozitat e UA.nr.04/2008 për përdorimi të telefonave fikse dhe mobil në qeverinë e Kosovës.
- Të gjithë zyrtarët e Ministrisë të cilët kanë tejkalluar kuotat e lejuara të shpenzimeve telefonike me UA nr. 04/2008 t'i kthejnë paratë në BKK

### **3.3.11. Furnizim me aparat telefonik mobil**

Gjate ekzaminimit të lendes Furnizim me aparat telefonik mobil me nr prokurimi 210/08/006/136 ne vlere 6,930.00 euro kemi vërejtur:

- Furnizimi me telefona mobil te cilët nuk kane qene në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit dhe ne kontrate
- Furnizimi dhe pajisja e zyrtarëve tjerë të ministrisë të cilëve nuk ju lejohet pajisja me telefona mobil sipas UA-04/2008
- Furnizimi dhe pajisja me telefona mobil e kabinetit të ministrit (Ifone) ne vlere te larta 750euro 550 euro etj.

### **Konkluzion**

Furnizimi me telefona mobil për zyrtaret e ministrisë duke anashkaluar UA-04/2008 të nxjerre nga qeveria e Kosovës, ndikon në shpenzimin e fondeve publike në mënyrë të pa autorizuar dhe dëmtimin e BKK-së

### **Rekomandim 15**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH qe furnizimet me telefona mobil ti realizoj në pajtim me specifikacionin teknik te dosjes se tenderit dhe kontratës ,si dhe te veproj në pajtim me neni 8 të UA-04/2008 për përdorimi e telefonave fiks dhe mobil në qeverinë e Kosovës.

## **3.4. MENAXHIMI I PASURISË**

Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive kërkon që të regjistrohen te gjitha transaksionet dhe të mbahet regjistri kontabël në përputhje me Instruksionet Administrative nr. 2005/11 të lëshuara nga MEF.

### **3.4.1 Të gjeturat**

- Mos caktimi i komisionit për vlerësimin te pasurisë. MMPH disponon me një numër te madh te pajisjeve te vjetruara dhe qe janë jashtë përdorimit dhe komisioni do duhej te bënte një vlerësim për te gjitha pasuritë duke përfshire edhe pasuritë e dëmtuara si dhe te bënte vlerësim eventual te kërkesave për tjetërsimin e tyre.
- Gjate ekzaminimit te pasurisë kemi vërejtur se MMPH nuk ka marre masa për rikthimin e pasurisë ( llap top), nga ish zyrtarja e ministrisë.
- Mos harmonizim i vlerave totale te pasurisë nga regjistri i thesarit me regjistrin e përgjithshëm te pasurisë me te cilin disponon ministria.
- Pasurit e MMPH nuk janë prezentur ne pasqyrat financiare ,duke mos i u përmbajtur UA-2008/13

### **Konkluzioni**

Mosrespektimi i dispozitave te UA 2005/11 ndikon ne prezantimin jo te sakte te pasurive ne regjistrat e pasurisë dhe regjistrat kontabël.

## **Rekomandimi 16**

Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që të beje vlerësimin e rregullt të pasurive ,te merre masa për rikthimin pasurive nga ish zyrtaret e ministrisë si dhe të harmonizoj regjistrin e pasurisë me regjistrin e thesarit ,respektivisht të veproj me përpikëri sipas UA 2005/011.

## **3.5. MENAXHIMI I AUTOMJETEVE**

Udhëzimi Administrativ i MSHP –se nr. 03/2008 – Për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës përcakton mënyrën se si automjetet mund të përdoren, si të mirëmbahen dhe çka duhet raportuar.

Ne këtë Ministri kemi ardhur në përfundim se nuk ekziston një kontroll e adekuate mbi menaxhimin e automjeteve. Gjate intervistës me zyrtarin e logjistikes si dhe ekzaminimin e automjeteve kemi vërejtur se në kuadër të MMPH gjate vitit 2008 kane qene në përdorim 37 automjete ,ndërsa ne kemi ekzaminuar 8 lende (dosjet e Automjeteve).

### **3.5.1 E Gjetura**

- Automjetet zyrtare janë marre në përdorim pa aprovimet përkatëse.
- Mungesë të evidencave mbi kilometrat e kaluara gjate shfrytëzimit të automjeteve .
- Mungojnë kërkesat për udhëtimet zyrtare si dhe përshkrimet e qarta për qëllimet e shfrytëzimit të automjeteve.
- Me rastin e aksidenteve të automjeteve zyrtare nuk ekzistojne raporte zyrtare nga organet kompetente të cilat japin vlerësimet rreth aksidenteve .
- Gjate testimi të faturave sa i përket servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve kemi vërejtur se brenda një periudhe shume të shkurtër janë bere ndërrime të shpeshta të pjesëve të njëjta të të njëjtit automjetet.
- Gjate testimit të faturave sa i përket servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve shumica e pozicioneve në fature nuk kane qene në spcifikacionin teknik të dosjes së tenderit.

### **Konkluzioni**

- Mungesa e një kontrolli mbi automjetet do të ndikoj qe automjetet e ministrisë të shfrytëzohen në mënyre joekonomike ,jo efikase si dhe jo racionale dhe të shkaktohen shpenzime për qëllime të pa aprovuara .

## **Rekomandimi 17**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që të forcoj kontrollet rreth mënyrës, formës dhe shfrytëzimit të automjeteve zyrtare.
- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që të veproj në pajtim me Udhëzimin Administrativ 2003/8 për përdorimin e automjeteve të qeverisë së Kosovës.

## **4. SISTEMI I KONTROLLIT TE BRENDESHEM DHE AUDITIMI I BRENDSHEM**

Dokumenti i politikave qeveritare përcakton Objektivat kryesore të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ( MFK) e që janë për të siguruar:

- Besueshmëri dhe integritet të informatave;
- Përputhje me politika, plane, procedura, ligje, rregullore dhe standarde;
- Ruajtje të pasurive;
- Shfrytëzim ekonomik, efikas dhe të efektshëm të burimeve

Për te vepruar ne pajtim me praktikat e qeverisjes se mire MMPH eshte dashur qe gjate aktivitetit te saj ti kushtojë rendësi:

- Vlerësimit të besueshmërisë, përshtatshmërisë dhe efikasitetit të llogari mbajtjes, kontroleve operative dhe administrative.
- Sigurimit që kontrollet e brendshme rezultojnë në regjistrimin e menjëhershëm dhe të saktë të transaksioneve dhe ruajtjen e duhur të aseteve.
- Sigurimit se MMPH-ja vepron në pajtim me ligjet dhe rregulloret dhe nëse u përmbahet politikave të përcaktuara nga Qeveria .
- Sigurimit se është duke ndërmarr hapat e duhur për adresimin e mangësive të tanishme dhe të mëhershme të kontrollit dhe rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit.

### **4.1. Të gjeturat**

Gjate auditimit ne MMPH kemi konstatuar se nuk ekziston një kontroll i mire i brendshëm sa i përket,aprovimit te pëlqimeve mjedisore , harmonizimit te raporteve në mes te sektorit te financave dhe Thesarit (SIMFK) , Po ashtu ende reflektojnë dobësi në menaxhimin e shpenzimeve te cilat janë realizuar përmes procedurave të prokurimit si dhe dobësi në menaxhimin e automjeteve.

### **Konkluzioni**

Mungesa e kontrollit të brendshëm ndikon në jo besueshmërinë e raportimit financiar ,anashkalim te ligjeve dhe rregulloreve te zbatueshme ,shfrytëzim jo efikas, jo ekonomik ,të aktiviteteve te rregullta dhe menaxhim të dobët .

### **Rekomandimi 18**

- Rekomandojmë Menaxhmentin e MMPH që te ngrite në nivelin e duhur sistemin e kontrollit te brendshëm me theks te veçanta ne procedurat e te hyrave ,shpenzimeve si dhe menaxhimin e pasurisë, ne mënyre qe raportimi te jete më i sakte ,dhe te eliminohen lëshimet e evidentuara.

## **5.1. Auditimi i brendshëm**

Ekzistimi i njësive të brendshme audituese, të cilat duhet të jene të strukturuar mirë dhe efektive në kuadër të secilës Ministri, është element kyç i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm i cili është i dizajnuar për të parandaluar dhe zbuluar gabimet dhe parregullsitë, qofshin ato të shkaktuara nga pakujdesia apo me qellim.

MMPH ne periudhën kohore janar- korrik nuk kishte auditor te brendshëm për arsye se ishte larguar nga puna dhe plotësimi i atij posti ishte vonuar pa ndonjë arsye te justifikueshme.

Gjate periudhës kohore Korrik –Dhjetor Auditori i brendshëm kishte kryer vetëm një auditim në Zyrën e personelit me objektiv „Zbatimin e Procedurave të rekrutimit në MMPH ”.

Gjate kohës kur ne ishim ne proces te auditivit, MMPH kishte rekrutuar edhe një auditor me qellim te kompletimit te njësisë se auditimit , qe është një hap i mire drejt funksionalizimit te njësisë se auditivit te brendshëm ne MMPH.

### **Konkluzioni**

Mungesa dhe vonimi i rekrutimit te stafit te auditimit te brendshëm, ka shkaktuar qe ne MMPH te ketë vështirësi ne funksionimin e duhur te sistemit te kontrollit te brendshëm gjate gjysmës se pare te vitit 2008.

### **Rekomandimi 19**

- Rekomandojmë Menaxhmentin te MMPH te inkurajoje punën e Njësisë se Auditimit te Brendshëm dhe qe ne raste te mungesës se stafit te filloj sa me shpejte procedurat e rekrutimit me qellim te plotësimit te vendeve vakante ne ministri.
- Auditorit të brendshëm t'i jepet pavarësi e plotë në ushtrimin e funksionit të tij dhe përmbushjen e Planit vjetor të punës të cilin paraprakisht duhet ta ketë të aprovuar nga Menaxhmenti.

## Shtojca 1.

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalesje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalesjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionin i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtitimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i

mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinioni.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca 2. Komentet e Ministrisë dhe Përgjigjet e Auditorit

	Komentete e MMPH	Përgjigjet e Auditorit
<b>1</b>	<b>Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar</b>	
1	Eshte e vertet kjo por duke pasur parasysh se shumica e projekteve te cilat bartin ne vete nje kosto te madhe te buxhetit nuk kane mundur te realizohen per shkaqe te kontesteve pronesore qe eshte dashur qe komunat ti marrin persiper qe ti zgjedhin	Nga analizimi i planifikimeve dhe shpenzimeve ne kuadër te MMPH si dhe raporti i shpenzimeve te realizuara ne raport me planifikimet ,shihet se ekziston një diferencë e madhe ndërmjet planifikimeve si dhe shpenzimeve te realizuara . Prandaj MMPH duhet ti analizoj të gjithë faktorët me rastin e planifikimit te shpenzimeve . Entiteti është pajtuar me te gjeturën
<b>2</b>	<b>Pasqyrat Financiare</b>	
2	Pasqyrat financiare janë përgatitur ne përputhje me U/A te MFE 2008/13. Për ndryshe nuk do te pranoheshin nga MEF-i.	Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e Menaxhmentit të MMPH-së. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte te këtyre pasqyrave financiare , U/A i MEF nr 2008/13 kërkon qe pasurit te prezantohen ne P/F ,ndërsa ne P/F te MMPH nuk janë prezantuar pasurit . E gjetura mbetet
<b>3</b>	<b>Te Hyrat</b>	
3.1	MMPH ka bere dy barazime per te hyrat gjate vitit 2008 me departamentin e thesarit dhe sistemi fre balance, se te gjitha shenimet qe gjinden ne pasqyra financiare jane te sakta dhe te besueshme, lidhur me barazimet ekzistojne dhe deshmite. Barazimi parë 07.07.2008 dhe barazimi i dyte 27.01.2009 qe me vlere totale 79,638.80	Edhe pse nga raportet e barazimeve në mes te MMPH dhe thesari potencohet se te dhënat e prezantuar janë të njëjta .Nga analizimi i dokumenteve burimore interne te MMPH shihet se te hyrat e realizuar bazuar në dokumenta interne janë 72.762 ,ndërsa te prezantuar në P/F janë 79.639 euro. E gjetura mbetet
<b>3.2</b>	<b>Pagat dhe meditjet</b>	
	Te gjitha kerkesat per nisme te rekrutimit jane (ato te cilat mendohen qe mungojne jane ne nje format ndryshe nga kerkesa). Edhe nese ka munguar vendimi mbi emerimin e	Bazuar në UA –MSHP/DASH 2003/01 ,formimi i komisionit për selektimin dhe intervistimin e kandidateve për punësim duhet te behet në baze te vendimeve të caktuara .

	komisioneve selektuese dhe intervistuese, sekretari i perhershëm ka aprovuar perberjen e panelit ne listen e kandidateve te diet kane aplikuar.	E gjetura mbetet.
<b>3.3</b>	<b>Prokurimi</b>	
3.3.1.	<b>Prokurimi i realizuar jashtë planit të prokurimit Furnizimi me reagense.</b> Kjo ka ardhur si nevojë urgjente për shkak të rritjes së kërkesave për ekzaminimin e lendeve dhe kryerjen e analizave	Shpenzimet urgjente janë kur entiteti nuk mund të parashikoj brenda një periudhe të caktuar kohore. Furnizimi me reagensa është bërë edhe në vitet paraprake ,kështu që planifikimi me reagensë nuk ka paraqitur një nevojë urgjente për MMPH-ë E gjetura mbetet
3.3.1	<b>Parku në Mitrovicë</b> Kjo ka ardhur si dhuratë për qytetaret e Mitrovicës pas kursimit të mjeteve që Qeveria ka ndarë për asgjësimin e materive të rrezikshme ky prokurim ka ardhur emergjent dhe nuk ka pasur mundësi të planifikohet.	Në bazë të informacioneve shtesë nga MMPH dhe rishikimit të bërë për parkun në Mitrovicë , shihet se prokurimi është bërë në bazë të vendimit të Qeverisë ,komenti i MMPH-se pranohet.
3.3.2	<b>Nënshkrimi i kontratave para vlerësimit të ofertave</b> Ka ndodhur gabim teknik në raportin e vlerësimit	MMPH me rastin e nënshkrimit të kontratave si dhe raporteve të vlerësimit duhet të jetë me e kujdesshëm në mënyrë që të bëhet evitimi i gabimeve të mundshme teknike. E gjetura mbetet.
3.3.3	<b>Nënshkrimi i kontratave para zotimit të mjeteve</b> Zotimi i mjeteve mund të bëhet vetëm në sasinë e caktuar për lidhjen e kontratës konform procedurës kurse zotimet tjera mund të vijne sipas kërkesave deri në realizimin e kontratës e cila është e lidhur për shumë të caktuar	Bazuar në nenin 8.2 të LPP si dhe si dhe udhëzimet e thesarit entiteti nuk mund të hyjë në obligime pa zotimin e mjeteve . E gjetura mbetet
3.3.4	<b>Kryerja e pagesave pa raporte të pranimit teknik</b> Asnjë pagesë nuk mund të realizohet pa raport të	Në të gjitha rastet ,pagesat ndaj operatorëve ekonomik për punët e realizuara duhet

	<p>pranimit teknik mirepo ne disa raste eshte leshuar pa situacion te puneve por vetem ne baze te kushteve te pageses te specifikuara ne kontrate ku jane shprehur kestet ne perqindje te punes se realizuar</p>	<p>lëshohen në baze te raporteve të pranimit teknik(situacion te Punëve ). E gjetura mbetet</p>
3.3.6	<p><b>Mungesa e komisioneve per pranim te puneve</b> Kane ekzistuar dhe jane bere ne baze te rregullave</p>	<p>Nga ekzaminimi i lendeve te caktuara, në disa raste ka munguar komisioni i pranimit te punëve, për këtë posedojmë dëshmi bindëse nga ekzaminimi i lendeve te caktuara. E gjetura mbetet</p>
3.3.7	<p><b>Furnizim me derivate</b> Eshte nderpre kjo kontrate dhe eshte shpallur tender i ri</p>	<p>Gjate vitit 2008 furnizimi me derivate është bere në baze te kontratës me nr 210/07/009/111 ,ndërsa për një kontrate te re për furnizim me derivate do te mbetet te analizohet gjate auditivi të P/F të vitit 2009 E gjetura mbetet</p>
3.3.8	<p><b>Furnizim me pije dhe mjete pune</b> Per mjete te punes nuk eshte parashtruar nevoja per ti blere ngase ne projektet tona kane ndihmuar edhe ndermarrjet tjera publike dhe ato i kane kryer punet.</p>	<p>Gjate planifikimit te blerjeve duhet te përcaktohen qarte nevojat për blerje nga MMPH-se ,në mënyre qe ne dosjen e tenderit të mos përfshihen furnizime te panevojshme . E gjetura mbetet</p>
3.3.8	<p><b>Furnizimi me derivate te naftës dhe benzinës për nevoja te MMPH-se;</b> Ne kete pike auditori ka cekur se operatorit i eshte paguar edhe marzha, gje qe mendojme se eshte normale dhe kjo shihet edhe ne dokumentin e tenderit, ku nje kopje i sjellim si deshmi auditorit, ku shihet qarte se eshte e perfshire edhe marzha e llogaritur</p>	<p>Nga ekzaminimi i lendes furnizim me derivate te naftës dhe benzinës për nevoja te MMPH me nr kontratës 210/07/009/111 përshkruhet në mënyre të qarte se furnizimi me derivate do te behet sipas çmimeve fikse ose sipas Bursës .Ndërsa pagesa e shtesës (premiumit) nuk është parapare në kontrate. E gjetura mbetet</p>
3.3.1 1	<p><b>Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile;</b>Tejkalimi i shpenzimeve te telefonise fikse, arsyetohet duke pasur per baze proporcionin e zyrtareve shfrytezues dhe numrave ekzistues. Kjo do te thote se nje numer telefoni ka mundesi ta shfrytezojne deri 10 ose me teper persona, gje qe si rezultat ngritet vlera e shpenzimit, por ne perpjesetim me numrin e shfrytezuesve kjonuk do</p>	<p>U/A nr 04/2008 përcakton qarte limitin e shpenzimeve për telefona fiks dhe mobil nga zyrtarëve te ministrisë , ndërsa nuk bene ndonjë përpjesëtim te shpenzimeve te telefonave me numrin e zyrtarëve . E gjetura mbetet</p>

	<p>te jete vlere me e madhe se 10 €, sa eshte e lejuar per cdo zyrtar te rendomte, duke mos marre per baze nivelet tjera.</p> <p>Telefonia mobile, gjithashtu jane shfrytezuar kontratat me Vala, si forme lehtesimi, ndersa pervec kesaj tejkalime te vlerave te lejuara nuk ka pasur, apo ato kane qene shume te vogla, gje qe pervec verejtjeve qe ju kemi bere' stafit per tejkalimet dhe mos perseritjen e tyre, kemi bere edhe raportet e tejkalimeve kur ato kane ndodhur</p>	
<b>7</b>	<b>Menaxhimi i pasuris</b>	
7	<p>Komenti i MMPH-se</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e pasurise e konstatuar si pasoj e vjedhjes se pasjeve te zyrtareve qe kane qen te ngarkuar me to per kete rast procedurat i vazhdon policia adresa tek ne eshte procesverbali i policise.</li> <li>• Per shkak te nje rrjedhjes se nja gabimi teknik ne sistemi free balance nuk mund te barazohen me shenime te ministrise</li> <li>• Pasurit jane te prezantuara ne pasqyra financiare.</li> </ul>	<p>MMPH duhet te hartoj politika si dhe procedura për menaxhimin e pasurisë . MMPH duhet ti harmonizoj raportet me thesarin</p> <p>Nuk është ofruar dëshmi se ne pasqyrat financiare janë prezantuar pasurit .</p> <p>E gjetura mbetet</p>
<b>8</b>	<b>Menaxhimi i automjeteve</b>	
8	<p>Tek shfrytezimi i automjeteve zyrtare, duhet theksuar se ne perzgjedhjen e veturave per ekzaminim nga auditori ka pasur edhe vetura nga stafi politik, respektivisht Kabineti i Ministrit, dhe me keto vetura nuk menaxhon drejtperdrejt logjistike gje qe si rezultat ka edhe mangesi ne mbajtjen e dosjeve ne perpikeri sikur specifikon Udhezimi Administrativ i MSHP-nr. 03/2008. Pra te keto dosje jane hasur gjetjet si : mungesa e aprovimit; evidenca e kilometrave te kaluara apo destinacioni; kerkesat per udhetime zyrtare.</p> <p>Automjetet zyrtare jane marre ne perdorim pa aprovim perkates; Mungesa e evidences mbi kilometrat e kaluara gjate shfrytezimit te automjeteve; Mungesa e kerkesave per udhetime zyrtare;</p>	<p>Te gjitha automjetet e ministrisë duhet te menaxhohen nga sektori i logjistikes ,prandaj te gjitha dosjet e veturave duhet te jene te kompletuara .</p> <p>E gjetura mbetet</p>

	<p>Mungesa e raportit te aksidentit nga organet kompetente; pjesen e logjistikës ,raportin e vozitesit per aksidentin dhe Aneksin 6 raporti i aksidentit, iu kemi deshmuar auditorit); ne rastet e larte cekura ka mundesi qe te jane shkelur dispozitat e U.A 03/2008 por kryesisht jane raste kur jane te implikuar stafi politik I KM.</p>	
<b>4</b>	<b>Kontrolli i brendshem</b>	
4	Funksionon	<p>Gjate auditimit të MMPH-se, si dhe nga testimet e kontrollit te brendshëm kemi vërejtur se mungon një kontroll adekuat sa i përket Aprovimeve për pëlqimet mjedisore, si dhe harmonizimit të raporteve te te hyrave në mes sektorit te financave dhe Thesarit . E gjetura mbetet.</p>
<b>5</b>	<b>Auditimi i brendshem</b>	
5	I kompletuar, organizuar dhe funksional	<p>Në kuadër të MMPH gjate vitit 2008 njësia e auditimit të brendshëm nuk ka qene e kompletuar si dhe funksionale. Në përdhën Janar –Qershor 2008 MMPH nuk kishte rekrutuar auditor të brendshëm. E gjetura mbetet</p>